

VENDIM
Nr. 231, datë 27.10.2020

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “PËR
PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE
LIGJORE PËR REKRUTIMIN, EMËRIMIN SI MAGJISTRAT DHE CAKTIMIN
NË POZICION TË KANDIDATËVE PËR PROKURORË, SI DHE PËR
ZHVILLIMIN E KARRIERËS SË PROKURORËVE**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 32, 35, 36, 48 dhe 52 nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenet 164, pika 8; 166, pika 2; 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Pika 1, e germës “A”, e dispozitave tranzitore dhe të fundit të rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, ndryshon si më poshtë:

“Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimit kalimtar, me vendim të formës së prerë, i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të ligjit për statusin, për periudhën pasi vendimi ka marrë formë të prerë.”.

2. Pikat 2, 3 dhe 4, të germës “A” dhe pika 1, e germës “Ç”, të dispozitave tranzitore dhe të fundit të rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, miratuar me vendimin nr. 171, datë 27.9.2019, shfuqizohen.

3. Çdo referim në rregullore, në pikat e shfuqizuara sipas pikës 2 të këtij vendimi, shfuqizohet.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETAR
Gent Ibrahimi